

PROGRES RAPORTI 2013 I KOMISIONIT EVROPIAN, PËR SHQIPËRINË, NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK

Kapitulli 5: Prokurimi publik

Përsa i përket parimeve të përgjithshme, ka patur përmirësime në sistemin e rishikimit të prokurimit publik, si dhe është miratuar legjislacioni në fushën e koncesioneve.

Në sferën e dhënies së kontratave publike, Ligji i Prokurimit Publik u amendua në muajin Dhjetor me qëllim përafrimin e tij të mëtejshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ai përfshin dispozita mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave publike për punë, mallra dhe shërbime, dhe tani mbulon edhe sektorët utilitarë. Legjislacioni dytësor i miratuar në gjysmën e parë të vitit 2013 mbulon procedurat e prokurimit publik, përkufizimet e blerjeve të vogla dhe ofertave anomalisht të ulëta, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga autoritetet kontraktore. Gjithashtu, janë ripërcaktuar gjambat dhe penalitetet administrative në rast shkeljesh, për t'u dhënë më shumë përgjegjësi anëtarëve të komisioneve të procedurave të prokurimit. Numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit pati një rritje të lehtë gjatë vitit 2012, duke u llogaritur në 26.4% të të gjitha procedurave dhe në 14% të vlerës së përgjithshme të tenderave. Kjo tendencë vazhdoi edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2013. Rritja e numrit, si më sipër, ishte pjesërisht për shkak të vonesave në çeljen e fondeve të prokurimit të autoriteteve kontraktore, e kombinuar me afate të shtrënguara dhe planifikim të dobët.

Rëndësi pati miratimi në muajin Prill i Ligjit të ri për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, i ndjekur nga miratimi i legjislacionit dytësor dhe një strategjie për koncesionet në muajin Qershor. Koncesionet për hidrocentralet u përjashtuan nga ligji për një periudhë kalimtare prej katër vitesh.

Agjencia e Prokurimit Publik mori masa të mëtejshme për të siguruar transparencën e procedurave të prokurimit publik. Prokurimi elektronik ka vazhduar të punonojë mirë. Legjislacioni dytësor për prokurimin elektronik u amendua me qëllim shtrirjen e fushës së zbatimit edhe tek kontratat me vlerë mbi 72 Euro, si dhe kufizimin e hapësirave për interpretim nga ana e autoriteteve kontraktore. Numri i masave disiplinore të marra nga Agjencia e Prokurimit Publik kundrejt autoriteteve kontraktore u rrit nga 27 në 55 dhe numri i vërejtjeve nga 3 në 15 në 2012, krahasuar me vitin 2011, ndërsa numri i gjobave ra nga 40 në 29. Në gjysmën e parë të vitit 2013 u vendosën 26 masa disiplinore dhe 8 gjoba. Gjysma e këtyre rasteve u zbatuan nga APP pas raporteve përkatëse nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Agjencia e Prokurimit Publik filloi të kryejë monitorim më të plotë të procedurave të prokurimit. Prokurimi publik dhe koncesionet janë ende një ndër sektorët kryesorë ku KLSH ka konstatuar shkelje financiare. Institucioni auditues raportoi në muajin Mars 2013 se shkeljet e kryera nga autoritetet kontraktore, në nivel qendror dhe vendor, në lidhje me prokurimet publike për periudhën 2008-2011 i kanë shkaktuar shtetit një dëm financiar prej 3.1 milion Euro. APP vazhdoi të ofrojë trajnime me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi ndryshimet në Ligjin e Prokurimit Publik. Stafi i

Agjencisë u rrit nga 20 në 23 dhe dy specialistë të rinj mbulojnë koncesionet. Kapaciteti i APP-së dhe autoriteteve kontraktore duhet të forcohet për të siguruar zbatimin me efektivitet të legjislacionit të ndryshuar.

Në fushën e rishikimit në prokurimet publike, ndryshimet në Ligjin e Prokurimit Publik shfuqizuan institucionin e Avokatit të Prokurimeve, duke lënë Komisionin e Prokurimit Publik të merret me rishikimin dhe trajtimin e ankesave nga operatorët ekonomikë. Kjo ka ndihmuar në qartësimin e përgjegjësiave institucionale dhe pritet t'i bëjë më të efektshme procedurat. Kapaciteti administrativ i Komisionit u rrit nga 18 në 20 punonjës. Komisioni ka marrë 270 ankesa dhe ka dhënë 214 vendime. Është e nevojshme të garantohet pavarësia e tij profesionale.

Përfundim

Ka patur progres të mirë në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të prokurimit publik, koncesioneve dhe partneritetit publik privat me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në këtë fushë. Mekanizmat e rishikimit janë bërë të efektshme. Punë e mëtejshme nevojitet për të përmirësuar profesionalizmin e autoriteteve kontraktore dhe për të reduktuar shkeljet financiare në sektor. Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e prokurimit publik kanë avancuar në mënyrë të moderuar.